



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.123/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Bujar Muzaqi, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.10.2025, merr këtë

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.123/2025 datë 06.10.2025.

II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1000 Euro (njëmijë Euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. URDHËROHET Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojë posterin e vendosur në tunelin e rrugës "Idriz Gjilani" në lagjen Dardania, në Prishtinë, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën theksohet se më datë 06.10.2025, aktivistët e Lëvizjes

Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë kanë identifikuar se Partia Demokratike e Kosovës ka vendosur material reklamues zgjedhor banerë/posterë në hapësirat/objektet/rrugët publike, përkatësisht në tunelin e rrugës “Idriz Gjilani” në lagjen Dardania , në Prishtinë. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dispozitë me të cilën ndalohet vendosja e posterëve në apo mbi rrugët publike. Me tutje thekson se vendosja e posterëve në udhëkryqin e përmendur përbën shkelje të qartë të kësaj dispozite ligjore, duke cenuar barazinë e subjekteve politike në procesin zgjedhor dhe duke e shfrytëzuar hapësira publike rrugore në mënyrë të kundërligjshme. Ky veprim përbën shkelje të dispozitave ligjore për fushatën zgjedhore. Në këtë rast, në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë parasysh shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e PDK-së, parashtruesi i ankesës PZAP-it i kërkon që të nxjerrë vendim me të cilin e aprovon këtë ankesë.

Provë: Fotografia e vendosjes së posterit në tunelin e rrugës “Idriz Gjilani” në lagjen Dardania, në Prishtinë.

Në përgjigje në ankesë “Partia Demokratike e Kosovës” (PDK), thekson se ka shpërndarë udhëzime të qarta dhe të detajuara për të gjithë anëtarët e saj, duke theksuar rëndësinë e respektimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo është një masë për të siguruar që të gjithë të angazhuarit në aktivitete zgjedhore të përmbahen nga përdorimi i hapësirave publike për fushatë. Më tej shtohet se Posterit i kandidatit është vendosur në një hapësirë të lejuar me ligj, për arsye se kompania e cila e ka postuar, posedon pëlqimin zyrtar të Komunës për vendosjen e posterëve në atë zonë si dhe kandidati ka lidhur kontratë të rregullt me kompaninë për shfrytëzimin e kësaj hapësirë dhe provat ia bashkëngjesin përgjigjes,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga prova materiale e bashkangjitur ankesës së Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoj se kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës ka vendosur material reklamues zgjedhor në tunelin e rrugës “Idriz Gjilani” në lagjen Dardania, në Prishtinë. Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur Rregullën Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që është shfrytëzuar hapësira publike për qëllime elektorale, veprime këto të cilat bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se 1.2.” *vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;*

Paneli i vlerësoj edhe pretendimet e paraqitura ne përgjigjen ne ankese te subjektit politik “Partia Demokratike e Kosovës” (PDK), ku thekson se *“Posteri i kandidatit është vendosur në një hapësirë të lejuar me ligj, për arsye se kompania e cila e ka postuar, posedon pëlqimin zyrtar të Komunës”*. Por, lidhur me këtë subjekti politik në fjalë nuk ka paraqitur asnjë provë. Andaj pretendimet në përgjigje në ankesë janë tërësisht të pa bazuara.

Subjekti Politik “Partia Demokratike e Kosovës” (PDK) ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj vendosja e materialit promovues në fushatë zgjedhore pa lejen e organeve kompetente, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, të cilat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, po ashtu fakti se është përsëritës i shkeljeve të tilla dhe se ky veprim i tyre përbën shkelje të dispozitave të sipërcituara ligjore. Po ashtu, Subjekti Politik, “Partia Demokratike e Kosovës” (PDK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, prandaj vendosja e posterëve-njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte publike, pa pëlqim të organit kompetent komunal përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe e njëjta shkelje është e sanksionuar me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli vlerëson se në rastin konkret subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës” (PDK), urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterin e vendosur në tunelin e rrugës “Idriz Gjilani” në lagjen Dardania, në Prishtinë, ndërsa dështimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe paragrafi 2, të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHITRESA

ZL.Anr.123/2025 më datën 08.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.